



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 4718 Prot

Tiranë më 13.12 2022

URDHËR

Nr. 669, Datë 13.12 2022

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR  
FINANCIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR, NË  
KUADËR TË FONDIT SOCIAL ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 21 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Komisionit për Vlerësimin, (më poshtë në tekst “Komisioni”), e kërkesave për mundësitë e financimit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga buxheti i shtetit, me këtë përbërje:

Znj. Denada Seferi	Zëvendësministër	Kryetar
Znj. Joana Duro	Sekretari i Përgjithshëm	Anëtar
Znj. Matilda Shabani	Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar
Znj. Reme Xholi	Drejtor i Përgjithshëm SHSSH	Anëtar
Znj. Nertila Topulli	Drejtor	Anëtar
Znj. Antoneta Njehrrëna	Drejtor	Anëtar
Z. Saimir Kadiu	Drejtor	Anëtar

2. Komisioni ka si objekt të punës së tij:

- a). Dokumentimin e të gjitha kërkesave për mundësi financimi të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore Bashki/Qark, përmes fondeve të buxhetit të shtetit;
- b). Shqyrtimin e të gjitha propozimeve, të ardhura nga bashkitë, për mundësi financimi të shërbimeve të kujdesit shoqëror, shoqëruar me Planin Social Vendor të miratuar, nga buxheti i shtetit në kuadër të Fondit Social.
- c). Shqyrtimin e të gjitha propozimeve, të ardhura nga Qarqet, për mundësinë e vazhdimit të financimit të shërbimeve ekzistuese apo ngritjes së shërbimeve të reja të specializuara dhe unike të kujdesit shoqëror, nga buxheti i shtetit në kuadër të Fondit Social, si dhe shkallën e mbulimit të financimit, në bazë të vlerësimit rast pas rasti dhe kriterit të nevojës më të madhe;

3. Komisioni i Vlerësimit asistohet nga Sekretariati Teknik (më poshtë në tekst "Sekretariati") me këtë përbërje:

- Znj. Xhilda Papajani Përgjegjës sektori për shërbimet sociale
- Znj. Anjeza Gjuzi Përgjegjëse sektori i buxhetit
- Znj. Anjeza Koroni Specialiste pranë sektorit të shërbimeve sociale
- Një përfaqësues nga SHSSH, nga sektori i buxhetit

4. Sekretariati ka si objekt të punës së tij:

- a) mbledhjen, arkivimin e aplikimeve të paraqitura pranë MSHMS-së, në rrugë zyrtare, dërgimin e njoftimeve për mbledhjet periodike të Komisionit, përgatitjen dhe paraqitjen në mënyrë të përmbledhur, të propozimeve të ardhura për financim nga buxheti i shtetit;
- b) siguron të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga komisioni për vlerësimin e kërkesave, si dhe shpërndarjen e tij, të paktën 1 ditë përpara mbledhjes së radhës;
- c) punonjësit e sektorit të buxhetit, të cituar në pikën 3 të këtij urdhri, janë përgjegjës për përgatitjen, bazuar në përllogaritjet financiare, të tabelave finale të financimit, si dokument shoqëruar i procesverbalit;
- d) sekretariati është përgjegjës për njoftimin zyrtar të aplikantit kualifikues, për vendimin e marrë nga Komisioni;
- e) punonjësit e sektorit të buxhetit, të cituar në pikën 3 të këtij urdhri, sigurojnë vijueshmërinë e procedurave të disbursimit të fondeve, si dhe përgatisin situacionet faktike të shpenzimeve të këtyre fondeve.

5. Komisioni shqyrton projekt – propozimet, si dhe bën vlerësimet përkatëse bazuar në: i) planet sociale të miratuara dhe të buxhetuara; ii) kriterin e nevojës më të madhe për shërbime sociale; iii) mbulimin më të mirë me shërbime sociale për cdo bashki, iv) shpërndarjen gjeografike dhe demografike të shërbimeve, v) situatën sociale dhe ekonomik të bashkive; vi) aplikimin për një shërbim të përbashkët që përfshin disa bashki kufitare, shoqëruar me një marrëveshje midis tyre.

6. Komisioni merr vendimin për shpërndarjen e fondeve buxhetore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Komisioni përgatit relacionin e vlerësimit për aplikimet e shqyrtuara dhe vendimet e marra.

7. Komisioni njofton me shkrim bashkitë e kualifikuara përfituese të Fondit Social, si dhe përgatit marrëveshjet e financimit të ngritjes dhe funksionimit të shërbimeve sociale.

8. Urdhri Nr. 466, datë 14.06.2019 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e kërkesave për financimin e ofrimin të shërbimeve të kujdesit shoqëror", i ndryshuar, si dhe Urdhri Nr.355, datë 01.06.2020 "Për përbërjen dhe përcaktimin e detyrave funksionale të Sekretariatit teknik të Grupit të Punës për vlerësimin e kërkesave për financimin e ofrimin të shërbimeve të kujdesit shoqëror", i ndryshuar, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Sekretariati Teknik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të hartojë Rregulloren e Funksionimit të Komisionit, që miratohet në mbledhjen e parë të Komisionit.

10. Ngarkohet Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit, për hartimin e Marrëveshjeve të Financimit me bashkitë përfituese, si dhe ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror për ndjekjen e zbatimit të tyre.

10. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror të realizojë, çdo 6 muaj, monitorimin për zbatimin e projekteve, ngritjen e shërbimeve dhe përdorimin e fondeve, në bashkitë përfituese, si dhe të raportojë pranë Komisionit.

11. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri Zëvendësministri përgjegjës për çështjet sociale, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Shërbimi Social Shtetëror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

